



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P-148
Prishtinë, më 19 dhjetor 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 19, 20 DHE 26 DHJETOR 2013**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Afërdita Berisha-Shaqiri, Rexhep Selimi, Burim Ramadani, Gëzim Kelmendi, Ganimete Musliu, Haki Demolli, Glauk Konjufca dhe Nijazi Idrizi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Muhamet Mustafa parashtrroi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me nivelin e buxhetit për universitetet e reja publike të Pejës, Mitrovicës, Gjilanit dhe Gjakovës. Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetit Muhamet Mustafa.

Deputetja Time Kadrijaj parashtrroi pyetje për ministrin Agim Çeku në lidhje me atë se deri ku është arritur në punën e Komisionit qeveritar për verifikim të dëshmorëve, të invalidëve dhe veteranëve të luftës.

Ministri Agim Çeku iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Valbona Dibra, parashtoi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me fazën përgatitore të Projektligjit për sigurim shëndetësor.

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Valbona Dibra.

Deputetja Time Kadrijaj parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me atë se konkursi i shpallur për drejtorë të klinikave të QKUK-së, a është në përputhje me ligjet në fuqi?

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se çfarë kushtëzimesh ka bërë Qeveria e Kosovës ndaj Serbisë, për përmirësimin e gjendjes së shqiptarëve në Luginën e Preshevës si dhe pse nuk është hapur zyra në Prishtinë dhe Gjilan deri më tani?

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Agim Kuleta parashtoi pyetje për ministrin Fadil Ismajli në lidhje me përdorimin e kodeve të huaja telefonike dhe hapat që janë ndërmarrë në këtë drejtim.

Ministri Fadil Ismajli iu përgjigj pyetjes së deputetit Agim Kuleta.

Deputetja Salihe Mustafa parashtoi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me kohën kur do të fillojë pagesa për personat verbër, e garantuar me ligjin në fuqi.

Ministri Nenad Rashiq nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Muhamet Mustafa parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me pakënaqësitë e ministrit lidhur me ndarjen e buxhetit për Ministrinë e Shëndetësisë për vitin 2014.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Muhamet Mustafa.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me shkeljen eventuale të ligjit nga ana e profesorit Azem Lajqi, a mendoni se të njëjtit është dashur ti ndalohet paraqitja para studentëve dhe të iniciohet marrja e titullit të profesorit?

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Deputetja Albana Gashi parashtoi pyetje për ministrin Enver Hoxhaj në lidhje me arsyen e mosarritjes së Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe ish- Republikës Jugosllave të Maqedonisë për sqarimin e dyshimeve lidhur me mbetjet e personave të pidentifikuar në ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Ministri Enver Hoxhaj nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Visar Ymeri parashtoi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me atë se a është pranuar aplikacioni për lojërat e fatit nga operatori Grand Casino dhe a është i licencuar ky operator?

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Visar Ymeri.

Deputeti Burim Ramadani parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me arsyen e moszbatimit të rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës lidhur me çështjen e parandalimit dhe luftimit të përdorimit të drogës nëpër shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetit Burim Ramadani.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për ministren Vlora Çitaku në lidhje me rezultatin e vizitës së ministres në SHBA dhe nivelin në të cilin ka arritur procesi i liberalizimit të vizave me SHBA-të.

Ministrja Vlora Çitaku iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Teuta Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota në lidhje me kohën e realizimit të projektit për ndërtimin e urës që lidh fshatrat e Lugut të Baranit dhe Lugut të Leshanit.

Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

Deputetja Kymete Bytyqi parashtroi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar në lidhje me atë se a do të zbatohet sistemi i ri i pagesave për shërbyesit civilë nga janari i vitit 2014?

Ministri Mahir Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Kymete Bytyqi.

* * *

Në vazhdim lidhur me rendin e ditës, për fjalë u paraqitën deputetët Arben Gashi dhe Visar Ymeri.

Arben Gashi propozoi që nga rendi i ditës së punimeve të mbledhjes së sotme të hiqet pika - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike dhe Media për shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Fjala e deputetit Arben Gashi është dhënë e plotë në transkript.

Visar Ymeri propozoi që nga rendi i ditës të punimeve të mbledhjes së sotme të hiqet pika - Debat parlamentar lidhur me ecurinë e procesit të negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Fjala e deputetit Visar Ymeri është dhënë e plotë në transkript.

Në lidhje me propozimin e deputetit Arben Gashi, kryesuesi kërkoi deklaratimet e grupeve parlamentare.

Për propozimin e deputetit Arben Gashi u deklaruan deputetët: Xhevahire Izmaku - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re dhe Milivoje Stojanović - në emër të Grupit Parlamentar ZB, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi hodhi në votim propozimin e paraqitur nga deputeti Arben Gashi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 39,

Kundër -----41

Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk miratoi propozimin për heqjen nga rendi i ditës të pikës - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike dhe Media për shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

* * *

Në lidhje me propozimin e deputetit Visar Ymeri, kryesuesi kërkoi deklaratimet e grupeve parlamentare.

Për propozimin e deputetit Visar Ymeri u deklaruan deputetët: Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re dhe Sasha Gjokiq - në emër të Grupit Parlamentar ZB diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi hodhi në votim propozimin e paraqitur nga deputeti Visar Ymeri.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 54,
Kundër -----28
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin për heqjen nga rendi i ditës të pikës - Debat parlamentar lidhur me ecurinë e procesit të negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Strategjisë për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Planit të Veprimit për vitin 2013-2017,
5. Shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2012,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012,
7. Debat parlamentar lidhur me raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013,
8. Debat parlamentar lidhur me ecurinë e procesit të negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,
9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
10. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike dhe Media për shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

* * *

3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet plenare të mëparshme

Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 5 e 12 dhjetor 2013 dhe më 12 e 13 dhjetor 2013, pa asnjë vërejtje.

4. Propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Strategjisë për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Planit të Veprimit për vitin 2013-2017

Kryesuesi tha se Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar Propozim-strategjinë për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Planin e Veprimit për vitin 2013-2017, të propozuar nga Qeveria e Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Deputeti Nait Hasani, në emër të Komisionit Funkcional e paraqiti dhe arsyetoi Raportin me rekomandime.

Ai tha se Komisioni që ai udhëheq ka rekomanduar që Propozim-strategjia për cilësinë e ajrit për periudhën 2013-2022, të miratohet nga Kuvendi, ndërsa Plani i Veprimit për periudhën 2013-2017, t'i kthehet Qeverisë për ripunim.

Diskutimi i plotë i deputetit Nait Hasani është dhënë në transkript

Në vazhdim, zv.kryeministri Bujar Bukoshi, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve Propozim-strategjinë për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Planin e veprimit për vitin 2013-2017.

Diskutimi i plotë i zv.kryeministrit Bujar Bukoshi është dhënë në transkript

Kryesuesi hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Rasim Demiri, në emër të Grupit Parlamentar “6+” dhe Sasha Gjokiq, në emër të Grupit Parlamentar ‘ZB’, si dhe Skënder Hyseni, Hamza Balje, Liburn Aliu, Salih Morina dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Propozim-strategjinë për cilësinë e ajrit për periudhën 2013-2022 dhe Planin e veprimit për vitin 2013-2017, sipas rekomandimeve të Nait Hasani, kryetar i Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 57,
Kundër -----0,
Abstenime ----- 8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia e Qeverisë së Republikës së Kosovës për cilësinë e ajrit për periudhën 2013-2022, me vërejtjet e Komisionit për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

2. Plani i Veprimit për vitin 2013-2017 i kthehet Qeverisë së Kosovës për ripunim.

5. Shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2012

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri tha se si Komision kemi shqyrtuar Raportin e performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2012 dhe kemi rekomanduar miratimin në mbledhje plenare. Diskutimi i deputetit Zenun Pajaziti është dhënë i plotë në transkript.

Deputeti Ali Sadriu, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike tha se Komisioni që ai udhëheq, ka vlerësuar se meqenëse ndërmarrjet publike në vitin 2012 nuk janë audituar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, ky Komision nuk ka nevojë ta shqyrtojë këtë raport.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike është i mendimit se ky raport duhet të renditet për shqyrtim në seancë plenare. Diskutimi i deputetit Ali Sadriu është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2012.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Shaip Muja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje"; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sasha Gjokiq, në emër të Grupit Parlamentar 'ZB', Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar "6+", si dhe Blerta Deliu-Kodra, Hykmete Bajrami, Albin Kurti, Amir Ahmeti, Hashim Deshishku, Teuta Sahatqija, Sadri Ferati si dhe ministri Fadil Ismajli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Raportin e performansës së ndërmarrjeve publike, për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 31,
Kundër -----38,
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk e miratoi raportin e performansës së ndërmarrjeve publike, për vitin 2012.

6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012

Kryetari i njoftoi deputetët se raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit FunkSIONAL e paraqiti dhe arsyetoi deputeti Zenun Pajaziti, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa e paraqiti dhe arsyetoi deputetja Safete Hadërgjonaj, diskutimi i plotë i së cilës është dhënë në transkript.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike e paraqiti dhe arsyetoi deputeti Ali Sadriu, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Valbona Dibra, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re; Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”; Sasha Gjokiq, në emër të Grupit Parlamentar ZB, si dhe Ramiz Lladrovci, Muhamet Mustafa, Sala Berisha-Shala, Nijazi Idrizi, Naser Osmani, Sadri Ferati dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, kryetari e hodhi në votim raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 19,
Kundër----- 38,
Abstenime----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk e miratoi raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2012.

* * *

Në vazhdim, deputetja Donika Kadaj-Bujupi propozoi që shqyrtimi i pikave vijuese të vazhdohet më 20 dhjetor 2013.

Lidhur me propozimin e lartpërmendur u deklaruan deputetët: Hydajet Hyseni, Myzejene Selmani dhe Blerta Deliu-Kodra, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari hodhi në votim propozimin e deputetes Donika Kadaj-Bujupi.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me anë të votimit formal, miratoi propozimin e deputetes Donika Kadaj-Bujupi.

Kryetari, konstatoi se Kuvendi përfundoi punimet për ditën e sotme, ndërsa vazhdimi i punimeve të kësaj mbledhje plenare do të bëhet më 20 dhjetor 2013, në orën 10:00.

* * *

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 17:10 minuta.

* * *

20 dhjetor 2013, ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 19 dhjetor 2013

Mbledhjen e kryesoi nënkryetari i Kuvendit Xhavit Haliti.

Kryesuesi deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 19 dhjetor 2013.

Kryesuesi, para procedimit me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, njoftoi Kuvendin lidhur me vendimin e presidentes së Republikës së Kosovës për zëvendësimin e ish-deputetit Idriz Vehapi, me deputetin Haxhi Shala, nga radhët e GP të PDK-së.

Kryesuesi i dëshiroi mirëseardhje deputetit të ri dhe e ftoi atë që ta nënshkruajnë tekstin e betimit.

Më pas deputeti i lartpërmendur nënshkroi tekstin e betimit.

* * *

Në vazhdim kryesuesi procedoi me pikat si në vijim:

7. Debat parlamentar lidhur me Raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013

Kryesuesi në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës tha se Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me Raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013.

Në vazhdim, kryesuesi e ftoi përfaqësuesen e Grupit Parlamentar të AAK-së, që në cilësinë e propozuesit të çështjes, ta marrë fjalën.

Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së tha se të gjatë vitit 2013, por edhe më herët, Raporti i Progresit për Kosovën shpërfaq dy aspekte të cilat përshkruajnë mënyrën e qeverisjes Thaçi. Aspekti i parë është dëgjueshmëria e pafund dhe lëshimi pe i Qeverisë dhe i kryeministrit Thaçi gjatë të gjitha proceseve politike të cilat gradualisht Kosovën e kanë sjell në pikën kur rrezikohet seriozisht funksionimi i shtetit duke instaluar mekanizma shtesë të pushteteve, të cilët nuk janë integruar, për më tepër janë paralelë. Dhe te këto të fundit dua ta përmend asociacionin të cilit kryeministri Thaçi po i referohet si OJQ, por themelimi i OJQ-ve nuk është subjekt i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe nëse është i tillë atëherë do të përbejë dhe do të paraqesë rrezik dhe ky nuk do të jetë rreziku i vetëm të cilin keq-qeverisja e Qeverisë Thaçi ia ka sjellë vendit.

Në Raportin e Progresit të vitit 2013, institucioneve të Kosovës i është kërkuar që t'i orientojnë politikat publike në adresimin e sfidave që lidhen me sundimin e ligjit, me funksionimin demokratik të institucioneve dhe zhvillimin tutje të agjendës evropiane, që do të thotë, konstatim i këtij raporti është që Kosova ende po ballafaqohet me pamundësinë dhe paaftësinë e institucioneve të saj për të treguar rezultate edhe në ushtrimin e funksioneve themelore të shtetit.

Në këtë kuptim raporti e qartëson që janë pikërisht këto probleme që Kosovës i pamundësojnë dhe vazhdojnë t'ia pamundësojnë liberalizimin e vizave dhe do ta shtyjnë ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Përfundimet që dalin nga ky raport janë shqetësuese dhe kërkojnë nga institucionet e Kosovës që sa më parë t'i adresojnë ato çështje.

Institucionet e pavarura të themeluara në këtë Kuvend, kontrollohen nga Qeveria dhe për derisa e kemi këtë gjendje është krejt e pamundur të besojmë që do të kemi institucione dhe agjenci të pavarura.

Rasti tjetër që lidhet me shqetësimin në Raportit të Progresit, është mënyrën se si Qeveria e trajton Kuvendin në rastet e veçanta dhe shumë të rëndësishme, siç është rasti i buxhetit, rasti i Postës kur përkundër shkeljeve të shumta të procedurave mundohet me çdo kusht të instalojë forma të presionit ndaj deputetëve për arritjen e qëllimeve dhe përpjekjeve që janë jashtëzakonisht të dëmshme për vendin, tha ajo.

Në vazhdim ajo tha se në Raportin e Progresit thuhet se Qeveria duhet të tregojë rezultate konkrete në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, të fuqizojë legjislacionin në këtë fushë si dhe të zbatojë atë. Dhe në fakt arsyeja kryesore që Kosova nuk e merr ende liberalizimin e vizave ka të bëjë pikërisht me krimin e organizuar dhe korrupsionin në vend.

Shqetësimi tjetër i theksuar ose e gjetura tjetër në këtë raport është interferimi i politikës në gjyqësor, që mbetet një problem serioz. Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial duhet t'u përgjigjen akuzave ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe institucioneve gjyqësore e të njëjtën gjë duhet ta bëjnë edhe Qeveria edhe Kuvendi.

Në fund, ajo tha se Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në vijim nëpërmjet deputetëve të vet do t'i prezantojë edhe të dhënat sektoriale veç e veç, të gjetura në raport dhe do të japim rekomandimet vijuese veç e veç, mirëpo për fat të keq, po e theksoj edhe një herë, po shihet që nuk ka gatishmëri ose vullnet politik që ato të zbatohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës e cila madje as nuk është e pranishme në Kuvend që t'i dëgjojë deputetët gjatë diskutimeve të tyre.

Diskutimi i znj. Donika Kadaj-Bujupi është dhënë i plotë në transkript.

Ministrja Vlora Çitaku, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, tha se Raporti i Progresit në fakt është vlerësim i punës së të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Procesi i integritetit evropian është shumë kompleks dhe ballafaqohet me shumë sfida. Integriteti drejt strukturave të Bashkimit Evropian nuk matet me vite as me afate kalendarike, por me rezultate dhe nga praktika mund të vërejmë se disa shtete kanë ecur më shpejt e disa të tjera më ngadalë.

Qeveria e Republikës së Kosovës deri në fund të këtij muaji do të miratojë planin e rishikuar të veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me qëllim të planifikimit të të gjitha aktiviteteve konkrete dhe afateve kohore për adresimin e rekomandimeve të Raportit të Progresit.

Në vazhdim ajo i adresoi disa nga gjetjet kyçe të Raportit të Progresit.

Funksionimi i Kuvendit dhe Qeverisë është karakterizuar me ngritje graduale të kapaciteteve në adresimin e prioritetëve të procesit të integritetit evropian, pra kjo është dëshmuar me

përmbushjen e kriterëve afatshkurtra dhe përgatitjeve që janë bërë për nisjen dhe mbarëvajtjen e negociatave të Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit.

Sa i përket sistemit gjyqësor është miratuar pakoja ligjore, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për Avokatinë Shtetërore dhe Ligji për procedurën përmbarese.

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial kanë miratuar strukturën e re të gjykatave dhe prokurorive dhe po ashtu është miratuar legjislacioni implementues sekondar.

Sa i përket reduktimit të lëndëve të vjetra në sistemin gjyqësor, është evidentuar progres.

Sa i përket sigurimit të lirisë së shprehjes janë amendamentuar dy nene të Kodit Penal me qëllim të evitimit të përgjegjësisë penale të medieve dhe mbrojtjen e burimit të informatave të gazetarëve.

Janë miratuar katër strategji dhe plane veprimi në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikimit me narkotikë dhe parandalimit të krimit si dhe është miratuar plani strategjik për bashkëpunim ndërinstitucional për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe është miratuar strategjia e re kundër korrupsionit dhe plani i veprimit.

Në fushën financimit të partive politike është evidentuar progres duke adresuar mangësitë e evidentuara me ndryshimet në Ligjin për financimin e partive politike.

Po ashtu, me Kodin e ri Penal, aktet e konfliktit të interesit dhe mos deklarimi i pasurisë, trajtohen si vepra penale.

Sa i përket zhvillimit ekonomik, Qeveria ka vazhduar angazhimin për realizimin e prioritetëve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social, bazuar në vizionin dhe prioritetet për zhvillimin ekonomik 2011-2014.

Njëkohësisht Qeveria ka ruajtur stabilitetin fiskal dhe financiar të vendit. Në funksion të këtij objektivi është implementuar me sukses Marrëveshja ‘stand by’ me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Po ashtu Republika e Kosovës është bërë anëtare e plotë e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës dhe e ka nënshkruar Marrëveshjen kornizë me Bankën Investive Evropiane.

Më tej ajo u fokusua në disa aspekte dhe të dhëna që kanë të bëjnë me bruto-produktin vendor, eksportet, investimet e huaja, mbledhjen e të hyrave nga tatimet dhe doganat, shkallën e grumbullimit të të hyrave nga Administrata Tatimore e Kosovës etj.

Ministrja më pas tha se kemi përmbyllur dy raunde të negociimit dhe raundi i tretë dhe final i negociatave për MSA është në muajt e parë të vitit të ardhshëm dhe ne presim që t’i përmbyllim negociatat dhe të nënshkruajmë Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit që sigurisht para se të nënshkruhet do të vijë për ratifikim në Kuvendin e Kosovës.

Diskutimi i znj. Vlora Çitaku është dhënë i plotë në transkript.

Blerta Deliu-Kodra, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së tha se në Raportin e Progresit për Kosovën vlerësohet se gjatë 12 muajve janë bërë përparime të konsiderueshme lidhur me perspektivën evropiane të Kosovës.

Sa i përket kapitullit për punën e Kuvendit thuhet se Kuvendi ka bërë hapa drejt përmirësimit të mbikëqyrjes së Qeverisë si dhe ka ofruar më shumë transparencë karshi shoqërisë civile.

Debati parlamentar si dhe interpelancat e ministrave kanë marrë notë pozitive në Raportin e Progresit për Kosovën. Raporti po ashtu vë në pah edhe një mungesë të koordinimit sa i përket ekzekutivit të legjislativit, sidomos për rastet e pyetjeve parlamentare në të cilat deputetët e Kuvendit jo gjithherë kanë marrë përgjigjet e tyre nga ministrat e nga këta të fundit kërkohet që ta respektojnë më shumë institucionin e Kuvendit.

Në vazhdim ajo u fokusua në vlerësimet dhe sfidat që Raporti i Progresit për Kosovën i evidenton sa i përket punës së Qeverisë, administratës publike, pagave të zyrtarëve të lartë, strategjisë antikorrupsion, ndryshimeve të neneve të Kodit Penal, si dhe çështja e pavarësisë së Komisionit të Pavarur të Medieve.

Diskutimi i deputetes Blerta Deliu-Kodra është dhënë i plotë në transkript.

Vjosa Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se raportet e progresit të çdo viti për Kosovën, përkundër asaj që evidentojnë edhe disa përparime, ato në veçanti vënë në pah ngecjet, sfidat dhe kërkesat e Komisionit Evropian në raport me Kosovën dhe konfirmojnë gjendjen reale në terren që institucionet e Kosovës e veçmas qytetarët e Kosovës e shohin çdo ditë.

Nëse krahasojmë gjetjet e raportit të këtij viti me vitin e kaluar, pra 2012, shihet se një sërë çështjesh kanë mbetur të pa adresuara dhe këto në veçanti kanë të bëjnë me sundimin e ligjit si shtyllë kryesore në këtë proces e në veçanti me çështje si lufta kundër korrupsionit, trafikimi me qenie njerëzore, ndikimi politik në institucione të pavarura, ndërhyrja politike në gjyqësor, pastaj mungesa e reformës së administratës publike, ekonomia jo konkurruese dhe mungesa e respektimit të të drejtave të njeriut, në veçanti mungesa e lirisë së medieve dhe shqetësimet e tjera.

Në vazhdim ajo u fokusua në vlerësimet dhe sfidat që Raporti i Progresit për Kosovën i evidenton sa i përket punës së Kuvendit të Kosovës, raportit ndërmjet Qeverisë dhe Kuvendit, zbatimit të ligjeve, rolit të Komisionit Parlamentar për Integrim Evropian, pastrimit të listave të votuesve dhe pavarësisë buxhetore të Kuvendit.

Diskutimi i deputetes Vjosa Osmani është dhënë i plotë në transkript.

Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” tha se përdorimi i fusnotës nga ana e BE-së është kontestues për shtetësinë tonë jo vetëm nga Serbia, sepse është etabluar si formë e përdorimit standard nëpër çdo dokument ndërkombëtar për Kosovën.

Rruga e Kosovës drejt Bashkimit Evropian po lidhet me atë se çfarë raporti kemi ne me shtetin e Serbisë, prandaj kjo është arsyeja e vetme pse Raporti i këtij viti është më i butë në gjuhën e tij kritike ndaj punës së Qeverisë.

Në vazhdim, ai tha se arsyeja kryesore që është fituar MSA-ja, është sepse Qeveria e Kosovës ka pasur fleksibilitet të madh ndaj kërkesave të Serbisë edhe pse do të ishte më mirë sikur të ishte e kundërta, sikur ta kishim fituar MSA-në dhe të kishim marrë notë të dobët në marrëdhënie me Serbinë, po të kishim marrë notë shkëlqyese në luftën kundër korrupsionit, demokracisë, sundimit të ligjit e kështu me radhë.

Më tej, ai u fokusua në vlerësimin që Raporti i Progresit për Kosovën i bën rolit të Beogradit në veri të Kosovës, për të cilin thuhet se ka qenë konstruktiv. Këtë konstatim ai e quajti të pavërtetë, sepse krijimi i potencialit destabilizues vjen nga Beogradi.

Deputeti Konjufca më pas tha se në Raportin e Progresit mund të gjendet edhe një e vërtetë lidhur me Marrëveshjen e energjisë elektrike, që ia mundëson Korporatës Elektroenergjetike të Serbisë të veprojë legalisht në veriun e Kosovës, ndërsa Qeveria e Kosovës po deklaron që atje po shpërbëhen strukturat paralele dhe shtetërore të Serbisë. Në këtë kontekst shtrohet pyetja, cila është e vërteta, kjo që po e thotë Qeveria, apo kjo që po e thotë Raporti i Progresit? Unë mendoj që kjo që po e thotë Raporti i Progresit është e vërteta.

Në fund, ai foli edhe për çështjet e tjera që dalin nga Raporti i Progresit për Kosovën që kanë të bëjnë me punën e gjyqësorit, emërimet nëpër borde të pavarura, raportin e Qeverisë me Kuvendin dhe të drejtat elementare të njeriut.

Diskutimi i deputetit Glauk Konjufca është dhënë i plotë në transkript.

Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së tha se edhe në këtë Raport të Progresit sfida kryesore për Kosovën mbetet lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, çështja e mungesës së kapaciteteve të mjaftueshme për luftimin e dukurive negative është e ndërlidhur me mungesën e vullnetit politik. Nuk është vullneti politik vetëm miratimi i ligjeve, strategjive, planeve të veprimit, krijimi i grupeve punuese, task-forcave, njësiteve dhe drejtorive të specializuara për ndalimin dhe luftimin e këtyre dukurive dhe për këtë flet qartë edhe vetë Raporti i Progresit ku thuhet se skema institucionale për luftën kundër korrupsionit mbetet komplekse, sistemi është i copëtuar në role dhe përgjegjësi të paqarta.

Në vazhdim ai u fokusua në vlerësimet e Raportit të Progresit për Kosovën lidhur me çështjet në menaxhmentin e Policisë, miratimin e ligjeve, strategjive, krijimin e mekanizmave tjerë institucional, zbatimin e strategjive kyçe për parandalimin dhe luftimin e krimit dhe luftimin e veprimeve antiligjore që ndodhin në Kosovë.

Diskutimi i deputetit Ahmet Isufi është dhënë i plotë në transkript.

Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re, fillimisht tha se sfidat të cilat paraqiten në Raportin e Progresit për Kosovën nuk janë sfida vetëm për Qeverinë, por janë sfida edhe për Kuvendin e Kosovës, për shoqërinë civile, për mediet dhe për të gjithë, në mënyrë që t'i plotësojmë kriteret e parapara për të qenë pjesë e BE-së.

Në vazhdim ajo u fokusua në disa aspekte të tjera që dalin nga ky Raport që kanë të bëjnë me marrëdhëniet në mes BE-së dhe Kosovës, procesin e stabilizim-asociimit, normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, sundimin e ligjit, punën e Kuvendit të Kosovës dhe çështjen e administratës publike.

Diskutimi i deputetes Myzejene Selmani është dhënë i plotë në transkript.

Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+” tha se në Raportin e Progresit për vitin 2013 është evidente se ka përparim të dukshëm, duke filluar nga marrëdhëniet tona me BE-në ku si sukses vlen të ceket fillimi apo hapja e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit në mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës, pastaj në sundimin e ligjit, në administratë publike, ku Kosova i ka përmbushur prioritetet e saja afatshkurta të studimit të fizibilitetit, si dhe u miratua legjislacioni dytësor i ligjeve për Shërbim civil dhe pagat për shërbyesit civilë.

Në vazhdim ai foli edhe për disa aspekte të tjera që dalin nga ky Raport që kanë të bëjnë me sistemin gjyqësor, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtat e njeriut, kriteret ekonomike, lëvizja e lirë e mallrave, si dhe mbrojtja e pakicave me theks në arsimimin dhe shërbimet sociale për komunitetin rom, ashkali e egjiptian.
Diskutimi i deputetit Albert Kinolli është dhënë i plotë në transkript.

Goran Marinković, në emër të Grupit Parlamentar 'ZB' tha se Raporti i Progresit për Kosovën, në përgjithësi përmban përparime të ndjeshme, mirëpo, gjithashtu ky raport përmban edhe probleme të caktuara, sidomos në lidhje me sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe mbrojtjen e komuniteteve pakicë.

Në vazhdim ai foli edhe për disa aspekte të tjera që dalin nga ky raport
Diskutimi i deputetit Goran Marinković është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi, më pas hapi diskutimet lidhur me këtë pikë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Arsim Bajrami, Alma Lama, Albin Kurti, Ardian Gjini, Suzan Novobërdaliu, Vjollca Krasniqi, Zenun Pajaziti, Hamza Balje, Albulena Haxhiu, Time Kadrijaj, Halit Krasniqi, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Kymete Bajraktari, Ramiz Lladrovci, Hykmete Bajrami, Aurora Bakalli, Teuta Haxhiu, Nazane Breca, Haki Demolli, Sadri Ferati, Nijazi Idrizi dhe ministrja Vlora Çitaku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, në emër të propozuesit të çështjes, në fund të debatit e paraqiti tekstin e rekomandimeve për miratim nga Kuvendi.

Në vazhdim, kryesuesi tha se Kuvendi nuk ka kuorum për të hyrë në procedurën e votimit, ndërsa lidhur me rekomandimet e paraqitura nga Donika Kadaj-Bujupi, konstatoi që ato duhet edhe një herë të harmonizohen ndërmjet grupeve parlamentare dhe të paraqiten në vazhdimin e mbledhjes plenare.

Kryesuesi tha se për vazhdimin e punimeve të kësaj mbledhje plenare vendos Kryesia e Kuvendit, në takimin e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryesuesi i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme në orën 16:05.

* * *

26 dhjetor 2013, ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 19 dhjetor dhe të vazhduar më 20 dhjetor 2013

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 19 dhjetor 2013 dhe vazhduar më 20 dhjetor 2013.

Kryetari, para procedimit me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, njoftoi Kuvendin me vendimin e presidentes së Republikës së Kosovës për zëvendësimin e deputetëve nga radhët e GP të LDK-së si në vijim:

Hatim Baxhaku, zëvendëson ish- deputetin Lutfi Haziri,
Xhavit Uka, zëvendëson ish- deputetin Imri Ahmeti dhe
Xhafer Tahiri, zëvendëson ish- deputetin Sali Asllanaj.

Kryetari u dëshiroi mirëseardhje deputetëve të rinj dhe i ftoi ata që ta nënshkruajnë tekstin e betimit.

Më pas deputetët e lartpërmendur nënshkruan tekstin e betimit.

* * *

Në vazhdim kryetari procedoi me pikën si në vijim.

7. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2013, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi me votim është shtyer për mbledhjen e sotme.

Ai më tej konstatoi se deputetja, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, në mbledhjen e mbajtur me 20 dhjetor 2013, ka paraqitur rekomandimet.

Në vazhdim, deputeti Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së paraqiti në Kuvend rekomandimet lidhur me debatin e lartpërmendur.

Më pas kryetari hodhi në votim rekomandimet nga debati parlamentar lidhur me Raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013, të paraqitura nga deputeti Ardian Gjini.

Rezultati i votimit ishte:

Për----- 95,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 2.

Kryetari tha se Kuvendi, me shumicë votash miratoi rekomandimet nga debati parlamentar lidhur me Raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nxori këto:

R E K O M A N D I M E

1. Qeveria e Kosovës urgjentisht t'i adresojë të gjeturat në Raportin e Progresit për 2013,
2. Qeveria e Kosovës të procedojë në Kuvend brenda një muaji Planin e veprimit për zbatimin e secilit rekomandim për të gjeturat në Raportin e Progresit,
3. Qeveria e Kosovës të raportojë në Kuvend për përmbushjen e këtyre kritereve në mënyrë periodike, në çdo tre muaj, duke filluar nga miratimi i tyre,
4. Qeveria e Kosovës deri në mars të vitit 2014, të publikojë dhe të raportojë në Kuvend lidhur me kërkesat e përmbushura sa i përket liberalizimit të vizave,
5. Të pavarësohet buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

6. Të pavarësohet sistemi i teknologjisë informative të Kuvendit,
7. Të miratohet Ligji për Kuvendin e Republikës së Kosovës, brenda periudhës sa më të shkurtër të mundshme,
8. Të miratohet Rregullorja e Kuvendit,
9. Kuvendi duhet t'i marrë të gjitha veprimet procedurale për ta detyruar Qeverinë e Kosovës që të jetë e pranishme gjatë mbajtjes së seancave plenare, si dhe t'u përgjigjet pyetjeve të deputetëve.

8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryetari, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, tha se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 16 dhjetor 2013, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në mbledhjen e sotme plenare t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve.

Në vazhdim, kryetari i ftoi kryetarët (përfaqësuesit e grupeve parlamentare) që t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad-hoc.

Pas paraqitjes së propozimeve nga ana e kryetarëve apo përfaqësuesve të grupeve parlamentare, kryetari hodhi në votim këto propozime.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 89,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës, në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaqi nga PDK, kryesuese,
2. Sali Morina nga LDK, zv/kryesues
3. Ramë Vataj nga PDK,
4. Alma Lama nga LDK,
5. Afrim Kasolli nga "Vetëvendosje",
6. Teuta Haxhiu nga AAK,
7. Suzan Novoberdaliu nga Koalicioni Kosova e Re,
8. Milivoje Stojanović nga ZB,
9. Albert Kinolli nga "6+", anëtarë.

II. Komisioni parlamentar ad hoc, në bazë të nenit 26, pika 2.3 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, duhet t'i shqyrtojë dhe t'i përzgjedhë kandidatët e paraqitur për anëtarë të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës.

9. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike dhe Media për shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ka diskutuar lidhur me shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit i ka rekomanduar shkarkimin e tyre.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit FunkSIONAL e paraqiti dhe arsyetoi deputeti Enis Kervan.

Ai konstatoi se Komisioni FunkSIONAL, në bazë të nenit 14 të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media, ka iniciuar procedurën për shkarkimin e z. Shefki Ukaj dhe Vesna Jovanoviq nga pozitat që mbajnë në këtë Komision.

Shkarkimi i anëtarëve të KPM-së bëhet kur vërtetohet se anëtari i KPM-së mban post publik, të zgjedhur dhe të emëruar, është anëtar i organit udhëheqës të një partie politike dhe merr pjesë aktive në jetën politike, theksoi ai.

Diskutimi i deputetit Enis Kervan është dhënë i plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Armend Zemaj, në emër të Nënkomisionit për Mandat, Imunitet dhe Rregullore; Arben Gashi, në emër të Komisionit për Legjislacion; Xhevahire Izmaqu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Jeton Svirca, në emër të Koalicionit Kosova e Re; Petar Miletiq, në emër të Grupit Parlamentar SLS; Milivoje Stojanoviq, në emër të Grupit Parlamentar ‘ZB’, si dhe Teuta Haxhiu, Sadri Ferati, Ali Sadriu, Adem Grabovci, Myzejene Selmani, Lirije Kajtazi, Blerta Deliu-Kodra dhe kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas kryetari hodhi në votim rekomandimin e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media lidhur me shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 34,
Abstenime ----- 6.

Kryetari tha se Kuvendi, me shumicë votash miratoi rekomandimin e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media lidhur me shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

1. Shkarkohen nga pozita e anëtarëve të Komisionin e Pavarur për Media, z. Shefki Ukaj, kryetar dhe znj. Vesna Jovanoviq, anëtare.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

* * *

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në ora 11 : 15.

* * *

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale